



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura IV**  
**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri**

Mbledhja nr. 60/2012  
Prishtinë, më 24.04.2012, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,**  
**TREGTI DHE INDUSTRI**

**Në mbledhje morën pjesë:** Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha – Shala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Visar Ymeri, Ramiz Kelmendi dhe Biserka Kostiq.

**Munguan:** Berat Buzhala dhe Myzejene Selmani.

**Pjesëmarrës të ftuar:** Besim Beqaj - ministër i Zhvillimit Ekonomik.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Frymëzim Isufaj, Agim Kukaj, Marcelë Restelica dhe Enver Basha – MZHE; Burim Ejupi dhe Krenar Gashi –INDEP; Agron Demi - GAP dhe Florije Mehmeti– KDI.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi, Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 11, 13 dhe 17.04.2012;
3. Raportim i ministrit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik të Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me përmbushjen e sfidave të dala nga Raporti i Progresit 2011, me theks të veçantë, në fushën e energjisë;  
I ftuar ministri Besim Beqaj (ministër i Zhvillimit Ekonomik);
4. Shqyrtimi i Raportit me propozimamendamente për Projektligjin nr. 04/L-109 për komunikimet elektronike;
5. Të ndryshme.

**Kryetari** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.*

## **2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhja e datës 11, 13 dhe 17.04.2012**

*Procesverbalet nga mbledhjet e datave 11, 13 dhe 17.04.2012 u miratuan pa vërejtje.*

## **3. Raportim i ministrit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik të Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me përmbushjen e sfidave të dala nga Raporti i Progresit 2011, me theks të veçantë në fushën e energjisë**

**Kryetari** – Theksoi se, ashtu siç është paraparë, në këtë pikë të rendit të ditës do të raportojë z. Besim Beqaj, ministër i Zhvillimit Ekonomik, i cili do të paraqesë një ekspozë lidhur me përmbushjen e sfidave të dala nga Raporti i Progresit 2011, me theks të veçantë në fushën e energjisë dhe pastaj do të hapim debat në lidhje me këtë çështje.

**Besim Beqaj (Ministër i Zhvillimit ekonomik)** – I njoftoi deputetët për hapat e deritashëm që ka marrë Ministria për përmbushjen e detyrimeve të dala nga Raporti i Progresit, për të cilat tha se ato janë arritur në masën më të madhe dhe është duke u punuar në përmbushjen e tyre në tërësi. Ministri Beqaj, në mënyrë kronologjike paraqiti hapat që ka marrë Ministria, duke filluar me Planin e Veprimit për reformat ekonomike dhe caktimin e prioritetëve, krijimin e politikave të përshtatshme për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, krijimin e mjedisit të favorshëm ligjor dhe nxitjen e shfrytëzimit të qëndrueshëm dhe përpunimit të resurseve. Ndër objektivat e tjera që Ministria synon të arrijë, ministri Beqaj radhiti furnizimin e qëndrueshëm dhe me cilësi të lartë me energji elektrike, ngritjen e shërbimeve publike për qytetarët, përmirësimin e infrastrukturës me energji, zëvendësimin e pajisjeve të tensionit të lartë, rritjen e sigurisë së operimit në sistemin e transmissioinit dhe objektiva të tjera, që do të ndikojnë drejtpërdrejt në jetën më të mirë të qytetarëve të vendit. Në vijim, ai foli edhe për TC "Kosova e Re" dhe privatizimin e PTK-së. Për sa i përket TC "Kosova e Re", ministri njoftoi se ndërtimi i tij do të bëhet në konsultim të ngushtë dhe me mbështetje të ekspertëve ndërkombëtarë. Ai me këtë rast përmendi mbështetjen nga Banka Botërore, ndërkaq për privatizimin e PTK-së tha se privatizimi i saj nuk do të ndodhë as nën presionin e kohës, e as nën presionin e mungesës së mjeteve financiare. Kriteret e privatizimit, tha ministri Beqaj, do t'i përcaktojë trendi i tregut, i cili do të vendosë për të.

**Visar Ymeri** – Duke u bazuar në raport, ngriti dy çështje: çështjen e privatizimit të PTK-së, që ishte e paraparë edhe me Ligjin për buxhetin e vitit 2011 dhe çështjen e Strategjisë së energjisë, e cila është miratuar në Kuvend. Lidhur me çështjen e privatizimit të PTK-së pyeti: Çka do të bëhet tani, pasi që ai Ligj është i shfuqizuar, cilat janë ndryshimet dhe kriteret për privatizimin e PTK-së? Për çështjen e Strategjisë së energjisë, e cila është miratuar në Kuvend, pyeti: Pse nuk po e njoftoni Kuvendin lidhur më vendimet e Qeverisë? A ka vendim Qeveria që miniera e Sibovcit të shpallet pasuri kombëtare dhe të jetë aset publik dhe a do të bëhet ndarja e minierave? A do të liberalizohet tregu i energjisë elektrike? Pse ka vendosur Qeveria që të shkojë me privatizimin total të të gjitha aseteve publike (shtetërore)? Pse nuk po përdoret metoda e privatizimit të partneritetit publiko - privat?

**Besim Beqaj (Ministër i Zhvillimit Ekonomik)** – Sa i përket privatizimit të PTK-së, Qeveria e Kosovës, në konsultim me Komitetin Ndërministror, ka marrë vendim që ta ndërpresë për një kohë privatizimin e PTK- së, në bazë të ligjit, derisa të mos ketë oferta të mjaftueshme për investitorë në këtë ndërmarrje publike. Ministria e Zhvillimit Ekonomik e ka bërë monitorimin e funksionalizmit të plotë të ndërmarrjes së re, Posta e Kosovës dhe është duke e bërë monitorimin e implementimit të kontratës së privatizimit të PTK-së. Për çështjen e Strategjisë energjetike, tha se kjo Strategji është paraparë të rishikohet çdo 3 vite dhe kjo është miratuar nga Kuvendi në vitin 2010 dhe ka kohë edhe për një vit për ta bërë rishikimin për plotësim - ndryshim. Për çështjen e minierës së Sibovcit dhe ndarjes së minierave, këto çështje janë të rregulluara me Ligjin për miniera dhe minerale. Sa i përket liberalizimet të tregut të energjisë elektrike, ne nuk mund të dalim jashtë parametrave të përcaktuar nga BE-ja ku na është rekomanduar që në vitin 2017 ta mbyllim Termocentralin “Kosova A” dhe të shkojmë më Termocentralin “Kosova B”, sipas standardeve evropiane. Ndërsa për çështjen e privatizimit të tërësishëm, tha se Qeveria nuk ka marrë vendim që të bëhet privatizimi i plotë i ndërmarrjeve publike, por i është lënë mundësia që me ndërtimin Termocentralit “Kosova e Re”, 49% të aseteve të sektorit të energjisë, të mbesin në pronësi publike, siç është miniera dhe pasuria e tyre të përdoret si lëndë e parë për shfrytëzim.

**Teuta Sahatqija** – Pyeti për çështjen e rregullimit të blerjes së energjisë dhe si është paraparë ndërtimi i Termocentralit “Kosova e Re”. Për projektin e ngrohjes qendrore peti: A ka ndonjë afat se kur do të përfundojë ky projekt? Për çështjen marrëveshjes për fusnotën që ka bërë Kosova me Serbinë, pyeti: A ka paraqitur deri më tani ndonjë pengesë për KEK-un për blerjen e energjisë? Ndërsa, lidhur me projektin e SCAD-it, pyeti: A pritët rritje të funksionalitetit? Ajo po ashtu kërkoi mendim edhe rreth 3G dhe 4G, si dhe për çështjen së digjitalizimit.

**Besim Beqaj (Ministër i Zhvillimit Ekonomik)** – Për blerje të energjisë elektrike ekziston baza ligjore nga KEK-u. Për Termocentralin “Kosovën e Re” janë bërë të gjitha përgatitjet dhe te çështja e privatizimit të KEK-ut, Komiteti i privatizimit deri më tani vetëm i ka shqyrtuar ofertat e investitorëve, por nuk ka marrë ende vendim për privatizim, sepse ka pasur kërkesa nga ofertuesit që t’ju mundësohet konsorciumi i përbashkët i kompanive për ta privatizuar distribucionin e shpërndarjes së energjisë elektrike. Për projektin e ngrohjes ekziston një marrëveshje për financim të përbashkët midis Komunës së Prishtinës dhe KFW-së, dhe deri në fund të vitit 2015, pritët të përfundojë ky proces. Ndërsa për marrëveshjen për fusnotë, lidhur për blerjen energjisë elektrike, kjo është kompetencë e KEK-ut, por deri më tani nuk jemi njoftuar që ka pasur ndonjë pengesë. Sa i përket projektit të SCAD-it, kontrollimi i hyrjeve dhe daljeve të energjisë, janë në nivelin më të lartë të mundshëm të funksionalizimit.

**Agim Kukaj (MZHE)** - Sa i përket Strategjisë digjitale, tha se është çështje e Qeverisë që në bazë të ligjit të secilit institucion, të japë këtë kompetencë dhe përgjegjësi. Për çështjen e 3G dhe 4G theksoi se këtë çështje e rregullon legjislacioni për komunikime elektronike.

**Fikrim Damka** – Pyeti për projektin e hidrocentralit të Zhurit se ku ka mbetur ky projekt. Ai pyeti edhe për asetet e PTK-së: Kush do të menaxhojë me këto asete? Lidhur me humbjet e energjisë elektrike pyeti: Cilët janë hapat që janë ndërmarrë për evitimin e këtyre humbjeve?

**Besim Beqaj (Ministër i Zhvillimit Ekonomik)** – Sa i përket hidrocentralit të Zhurit, tha se është një projekt që kemi kërkuar arsyeshmëri ekonomike. Në këtë rast, kemi autorizuar ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, që të merret me këtë projekt dhe është formuar një grup i punës se si do të rregullohet çështja e shpronësimit të pronave. Për asetet e PTK-së se kush do t’i menaxhojë, ai tha se 95% e objekteve do t’i mbesin Postës. Kjo është planifikuar që të ketë të hyra nga dhënia me qira e objekteve dhe të ketë investime shtesë vetë Posta. Lidhur me

humbjet e energjisë elektrike, tha se KEK-u, në bashkëpunim me KOSST-in ka investuar deri më tani shumë që humbjet të jenë sa më të vogla.

**Lutfi Zharku** - Ngriti dy çështje lidhur me PTK-në dhe KEK-un. Nëse lejohet edhe një operator tjetër, atëherë a do të kemi humbjen e vlerës së PTK-së? Cilët do të jenë hapat e ardhshëm të Qeverisë për vazhdimin apo ndërprerjen e privatizimit të PTK-së? Për ndërtimin e Termocentralit “Kosova e Re”, pse po shkohet me kapacitete kaq të vogla, pasi që kemi deficit të madh të energjisë elektrike? Si është planifikuar në të ardhmen furnizimi me energji elektrike, pasi që këto kapacitete nuk i përmbushin nevojat e konsumatorëve?

**Besim Beqaj (Ministër i Zhvillimit Ekonomik)** – Arsyeja e ndërprerjes së privatizimit të PTK-së është se pa u plotësuar kushtet për konkurrencë të investitorëve, nuk do të ketë shpallje të fituesit. Ne do t’i kryejmë të gjitha procedurat dhe do të presim ofertues dhe investitorë, ndërsa të këtë konkurrencë më të madhe. Për ndërtimin e kapaciteteve të Termocentralit “Kosova e Re”, ne kemi paraparë ndërtimin deri në 600 MGW, pastaj parashihet ndërtimi i hidrocentraleve, dhe prodhimi i energjisë me erë, si dhe zvogëlimin energjisë për nevojat e ngrohjes.

**Kryetari** – Pyeti në lidhje me energjinë e ripërtëritshme se a ka investitorë të interesuar nga kompanitë e huaja që të investojnë.

**Hashim Deshishku** - Pyeti lidhur me çështjen e thëngjillit: Pse po lejohet që thëngjilli të blihet nga jashtë për nevojat e Ferronikelit, ndërsa kemi sasi të mjaftueshme në Kosovë?

**Sala Berisha – Shala** – Kërkoj që, pasi që Komisioni ka paraparë në Planin e punës për vitin 2012 plotësim - ndryshimin e Ligjit për minierat dhe mineralet, të përkrahjet nga Ministra e Zhvillimit Ekonomik në grupet e punës me ekspertiza.

**Besim Beqaj (Ministër i Zhvillimit Ekonomik)** – U përgjigj pyetjeve të deputetëve. Lidhur me energjinë e ripërtëritshme, tha se deri më tani u kemi dhënë tri licenca kompanive për mundësinë e prodhimit të energjisë me erë. Në këtë aspekt, ka kërkesa edhe nga dhjetë kompani, por janë duke u shqyrtuar kërkesat e tyre që kur të merren licencat, vërtet të kemi investime në këtë fushë, sepse deri më tani ka pasur kompani që vetëm i kanë marrë licencat dhe ende nuk kanë investuar. Për çështjen e thëngjillit, ai tha se këto janë marrëveshje kontraktuese në mes të kompanive dhe ne nuk mund të ndërhyjmë në tregun e tyre, ndërsa për nevojat e veta, KEK-u ka shpallur tenderin për furnizim, ndërsa kjo është më shumë çështje brendshme e tyre sesi furnizohen me thëngjill. Për plotësim - ndryshimin e Ligjit për minierat dhe mineralet, tha se jemi të gatshëm që t’i ofrojmë përkrahje Komisionit nga të gjitha departamentet e nevojshme të MZHE-së.

*Pas debatit të gjerë, Komisioni unanimisht nxori këtë*

#### *Konkluzion*

*Komisioni do të vazhdojë me agjendën për integritet evropian, duke përmbushur detyrimet që ka në Planin e Veprimit të Kuvendit.*

#### **4. Shqyrtimi i Raportit me Propozimamendamente për Projektligjin nr. 04/L-109 për komunikimet elektronike**

**Kryetari** – Ia dha fjalën raportueses së grupit të punës, znj. T. Sahatqija që të paraqesë Raportin me propozimamendamente, edhe pse ishte i pajtimt që kjo pikë të shqyrtohet në një mbledhje të radhës.

**Teuta Sahaqija** – Theksoi se grupi i punës, në muajin e kaluar ka mbajtur një dëgjim publik dhe një punëtori ku ka shqyrtuar këtë Projektligj dhe në masë të madhe i kemi harmonizuar disa qëndrime dhe tani para vetes keni një raport me propozimamendamente.

*Pas debatit, Komisioni nxori*

### *Konkluzion*

*Shtyhet shqyrtimi i Raportit me propozimamendamente për Projektligjin nr. 04/L-109 për komunikimet elektronike, për në mbledhjen e radhës.*

## **5. Të ndryshme**

### **Çështjet vijuese**

**Kryetari** – I njoftoi deputetët se në bazë të dakordimit të fundit, në mbledhjen e radhës do të ftohet ministrja e Tregtisë dhe Industrisë që të raportojë dhe do të shqyrtohet Raporti me propozimamendamente për Projektligjin nr.04/L-109 për komunikimet elektronike, si dhe eventualisht ndonjë nga Raportet vjetore të rregullatorëve të pavarur.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30

### **E përgatiti:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit.**

**Zenun Pajaziti**

-----  
**Kryetar i Komisionit**